



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 933/ 2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha, kryesues, Ymer Hoxha dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Deçan, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në Deçan, për shkak të mospërputhjes së rezultateve, në seancën e panelit të mbajtur me 18.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), dega në Deçan

Arsyetim

PZAP, më datë 15.11.2013, ka pranuar ankesat: Anr. 933/2013, dhe Anr. 934/2013 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosoves (PDK), dega Deçan, me të cilat pretendohet se:

- Në ankesën Anr. 933/2013 të PDK-së pretendohet se pas përfundimit të publikimit të rezultateve preliminare nga KKZ-ja parashtuesi i ankesës ka vërejtur se nga bartja e të dhënave nga FRK në tabelat e KKZ-së në Deçan ka mospërputhje të të dhënave në Qendrat e Votimit 0101X/05R dhe 07D si dhe në QV 0105C/01R. Andaj parashtuesi i ankesës kërkon që të verifikohen këto të dhëna.
- Në ankesën Anr. 934/2013, të PDK-së pretendohet se pas përfundimit të publikimit të rezultateve preliminare nga KKZ-ja është vërejtur se nga bartja e të dhënave nga FRK-ja në tabelat e KKZ-së në Deçan ka mospërputhje të dhënave nga QV 0101X/05R dhe 07D si dhe QV 0105C/01R. Andaj parashtuesi i ankesës kërkon që të verifikohen këto të dhëna.

Paneli i PZAP-it në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i me datën 16.11.2013 ka kërkuar nga KQZ tërë materialin zgjedhor për qendrat e votimit QV 0101X/05R dhe 07D dhe QV 0105C/01R edhe atë si në vijim: listën përfundimtare të votuesve, formularin e përputhjes së rezultateve, formularin e rezultateve për kandidat dhe librin e vërejtjeve.

KQZ në përgjigjen e saj të datës 17.11.2013 në shkresën me nr. protokoli 1852/2013 ka informuar PZAP-in dhe i ka sjellë materialin e kërkuar për QV 0101X/05R dhe 07D dhe QV 0105C/01R duke ja bashkangjitur materialet zgjedhore si: Listën Përfundimtare të Votuesve, Formularin e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve, formularin e rezultateve të kandidateve dhe librin e votimit.

PZAP-i në mbështetje të nenit 117.2 dhe 117.4 të LZP-së si dhe në bazë të nenit 12 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it lidhur me ankesat e lartpërmendura ka shqyrtuar dhe hetuar tërë materialin zgjedhor të kërkuar ndaj KQZ-së, pretendimet ankimore të palës ankuese, provat që gjendet në shkresat e lëndës dhe se pas rezultateve hetimore të ndërmara nga PZAP-i dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç si dhe duke u bazuar në rezultatin e tërësishëm të provave të administruara në bazë të hetimit të bërë PZAP-i ka gjetur se:

Ankesat janë të pabazuara

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të pabazuara pasi që në bazë të hetimit dhe shqyrtimit të materialit zgjedhor si dhe në bazë të pretendimeve ankimore PZAP-i nuk ka gjetur prova të besueshme që do të vërtetonin pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, andaj pretendimet e tilla ankimore janë të pabazuara dhe të pa argumentuar në prova dhe në dëshmi bindëse, prandaj duke u bazuar në arsyet e lartcekura si dhe duke u mbështetur në nenin 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr. 933/2013 më datën 18.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*